



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	06.06.2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	03-250

Nr. ref. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Bazuar në dispozitat e Statutit dhe akteve të brendshme të Universitetit, dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, dispozitat e nenit 67, 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Universiteti "Ukshin Hoti" shpall:

## KONKURS

PËR EMËRIM, RIEMËRIM DHE AVANCIM TË PERSONELIT AKADEMIK

### I. FAKULTETI EKONOMIK

#### 1. Një asistent për lëndët:

- Statistika (MN-Bsc.);
- Menaxhimi i cilësisë (AB-Bsc.);
- Menaxhimi i zingjirit të furnizimit (AB- Bsc.);
- Makroekonomi (AB-Bsc.);
- Makroekonomi (MN-Bsc.);

### II. FAKULTETI JURIDIK

#### 1. Një mësimdhënës për lëndët:

- ABC-ja e së drejtës dhe shteti /Fillet e së drejtës, (6 orë, O);
- Drejtësia kushtetuese (6 orë, O);

#### 2. Një mësimdhënës për lëndët:

- E drejta familjare dhe trashëgimore, (6 orë, O);
- E drejta sendore, (6 orë, O);

#### 3. Një mësimdhënës për lëndët:

- E drejta romake (6 orë, O);
- E drejta kontraktore (6 orë, O);

### III. FAKULTETI I EDUKIMIT

#### 1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Hyrje në psikologji (Programi fillor, sem. III; 21-4-B-9-S3-O2, 3 orë);
- Psikologji edukimi (Programi fillor, sem. VI; 21-4-B-9-S6-O3, 2 orë);
- Psikologji e fëmijës (Programi parashkollor, sem. I, 21-4-B-10-S1-O4, 2 orë);
- Hyrje në psikologji (programi parashkollor, sem. III; 21-4-B-10-S3-O3, 3 orë).

#### 2. Një mësimdhënës për lëndët:

- Praktika pedagogjike II- 5 javë (Programi fillor, sem.III; 21-4-B-9-S3-O3, 2 orë);
- Praktika pedagogjike II- 5 javë (Programi parashkollor, sem.III; 21-4-B-10-S3-O3, 2 orë);
- Praktika pedagogjike III- 6 javë (Programi fillor, sem.V; 21-4-B-9-S5-O3, 2 orë);
- Praktika pedagogjike III- 6 javë (Programi parashkollor, sem.V; 21-4-B-10-S5-O3, 2 orë);
- Praktika pedagogjike IV- 8 javë (Programi fillor, sem.V; 21-4-B-9-S8-O2, 3 orë);
- Praktika pedagogjike IV- 8 javë (Programi parashkollor, sem.V; 21-4-B-10-S8-O2, 3 orë);

## I. Kushtet dhe dokumentacioni për aplikim

### 1. Dokumentacioni për aplikim:

- Kërkesën dhe CV-në,
  - Kopjen e diplomës përkatëse (për pozitën e mësimdhënësit, diploma e tri niveleve të studimeve; ndërsa për pozitën e asistentit në dy nivelet e studimit dhe certifikatën e notave) të nótërizuar;
  - Ekstraktin e lindjes (origjinale) dhe kopjen e letërnjoftimit;
  - Dëshminë nga gjykata mbi të kaluarën penale (origjinale);
  - Kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës duhet të paraqesin edhe vendimin për zgjedhjen e fundit si dhe raportin mbi vlerësimin e performancës (nëse aplikohet).
  - Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë;
  - Dëshmi mbi njohjen e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër/ përparësi.
2. Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën do të konsiderohet e pakompletuar dosja e aplikantit.

## II. Afati dhe mënyra e aplikimit

1. Afati për aplikim sipas këtij konkursi është nga data 7.6.2023 deri më 21.6.2023 ora 16:00.
2. Paraqitja e dokumenteve bëhet në Njësitë përkatëse akademike duke dorëzuar kopjen fizike si dhe të skanuara në CD; e njëjta në kopje elektronike e dërgohet edhe në email-in zyrtar: [apliko.upz@uni-prizren.com](mailto:apliko.upz@uni-prizren.com).
3. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato që janë të pakompletuara apo të parregullta nuk do të pranohen në konkurs (nuk do të shqyrtohen nga komisioni përkatës).
4. Njoftimin mund ta gjeni në portalin e konkurseve: [konkursi.rks-gov.net](http://konkursi.rks-gov.net) si dhe Konkursin (pas hapjes për aplikim) në faqen zyrtare të Universitetit: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com).

## III. Procedura e zgjedhjes së kandidatëve dhe e drejta e ankesës

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve sipas këtij konkursi dhe e drejta e ankesës realizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare: <https://uni-prizren.com>) dhe aktet tjera nënligjore.